

**Gjykata Themelore Ferizaj-Dega Kaçanik, Divizioni per Kundervajtje ,dhe ate gjyqtarja Zajrete Muhaxheri** me procesmbajtësen Indira Beqa , punetore e kesaj gjykate ,në lenden kundërvajtëse kundër të pandehurit Alajdin Daci nga Hani Elezit , për shkak të kundërvajtjes nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par l.nenpar.1.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare ,e në baze të nenit 31,73,74,199 dhe nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtje me dt. 19.11.2013 merr këtë;

### AKT V E N D I M

I pandehuri Alajdin ( Ilmi ) Daci ,i lindur me dt.13.12.1977 ne Shkup ,me vendbanim ne Han te Elezit , shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves, I martuar,prind I dy femijeve ,ka te kryer shkollen e mesme , keshilltare komunal ne Asamblene komunale ne Han te Elezit ,i gjendjes së mesme ekonomike,

### Ë sht ë për gje gj ë s

Sepse si zyrtare i larte publike ne poziten e keshilltarit komunal ne Asamblene Komunale ne Han te Elezit ,nuk e ka bere deklarimin e rregullt vjetor te pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit deri me daten 31.03.2012.

Me qka ka kryer kundervajtje nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.1.1 Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare

Andaj në bazë të nenit 31,73,74 dhe 199 te Ligjit per Kundervajtje dhe nenit 17 par 1 nenpar.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare,

### D E N O H E T

**Me denim me gjobe në shumë prej 300 € (treqind euro) ,te cilin eshte e obliguar qe ta paguaj në afat prej 15(pesëmbëdhjete ) ditësh nga dita e plotfuqishmërise të këtij aktvendimi,në të kundërtën ,konform nenit 5 al.1 të Ligjit per kundërvajtje,dënimi me gjobë do t'I zevendesohet me denim me burg ashtu qe per qdo dite burgu do t'I llogariten nga 15 (Njëzet ) €**

|   |                           |
|---|---------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO |                           |
| AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT                            |                           |
| AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE                               |                           |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY                                  |                           |
| Dep.  | Nr Prot                   |
| Dep. <u>DPK/DMP</u>                                     | Br Prot <u>03-4086/13</u> |
| Dep.  | Prot No                   |
| Nr. I faq   | Data                      |
| Broj stranica   | Datum <u>27.11.2013</u>   |
| Nr. pages   | Date                      |
| PRISHTINE   |                           |

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë pranë kësaj gjykate shumë prej prej 5.00 € në emër të paushallit gjyqësor në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

### A r s y e t i m

Agjensia Kunder Korrupsionit në Prishtinë, ka parashtruar kërkesën për fillimin e procedurës kundervajtëse nr.01-2347/12 të datës 02.07.2012, kundër të pandehurit Alajdin Daci nga Hani Elezit, për kundervajtje nga nenin 5, 6 dhe 9 i sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.3 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të denohet sipas ligjit.

Në bazë të kërkesës së parashtruar i pandehuri është marrë në pyetje nga ana e gjykatës me të cilin rast I pandehuri e ka pranuar përgjegjësinë për kundervajtjen, dhe sipas tij është neglizhuar dorezimi I formularit për deklarimin e pasurisë në afatin e përcaktuar me ligj, por që nuk ka patur për qëllim që t'i ik obligimit ligjor të deklarimit të pasurisë.

Për t'u deklaruar rreth kualifikimit juridik të kundervajtjes, gjyqtarja ftoi edhe përfaqësuesin e AKK, se, ku me atë rast përfaqësuesi me autorizim I AKK, se Enis Sadiku deklaroi se, mbetet në teresi pranë kualifikimit juridik të kundervajtjes, pasi që sipas tij e pandehura asnjehere me pare nuk e ka deklaruar pasurinë e saj pranë AKK, se, gjersa ka qenë në pozitën e keshilltarit komunal, pasi që kuptohet se edhe ligjerisht nuk ka patur obligim, e që për këtë arsye sipas tij nuk mund të konsiderohet se kemi të bëjmë me deklarimin e rregullt vjetor por me deklarimin sipas kërkesës së Agjensisë.

Gjykata, për të konstatuar faktin se I pandehuri Alajdin Daci a ka qenë I njoftuar me kohë nga ana e zyrtarëve kompetentë komunal për obligimin e deklarimit të pasurisë mori në pyetje në cilësi të deshmitarit zyrtar komunal të Hanit të Elezit, Driton Kaloshi, I cili në pyetjen e gjyqtarës deklaroi se, ka qenë pike kontaktuese për Agjensinë Kunder Korrupsionit në komunën e Hani Elezit deri kah fundi I vitit 2011, e me pas nuk ka shërbyer në këtë pozitë, mirepo në shkurt të vitit 2012 pranon se I ka dorëzuar agjensisë listën me emrat e zyrtarëve të lartë komunale të komunes së Hanit të Elezit cilet sipas ligjit kanë qenë të detyruar që ta deklarojnë pasurinë, mirepo shton se këta zyrtarë të lartë të përfshirë në listë nuk I ka informuar për obligimin e deklarimit të pasurisë duke vlerësuar se këtë është dashur t'a bëjë kryesuesi I kuvendit Mendu Vlasi dhe zyrtari komunal Kujtim Dernjani.

Për vertetimin me të plotë të gjendjes faktike gjyqtarja ka ftuar në cilësi të deshmitarit Mendu Vlasi, kryesues I Kuvendit Komunal Hani Elezit, I cili në fjalën e tij deklaroi se: keshilltari komunal Alajdin Daci ka qenë i njoftuar me kohë për obligimin e deklarimit të pasurisë pranë AKK, se në Prishtinë si nga ana e tij por edhe nga ana e sekretarit të Kuvendit të komunes së Hanit të Elezit, Avni Bushi dhe atë para datës 31.03.2012 dhe për ta vertetuar deklaratën e tij ka prezentuar para gjykatës kopjen e e-mailit të sekretarit të kuvendit të komunes Avni Bushi të datës 15.03.2012, nga I cili konstatohet se keshilltari komunal Alajdin Daci me

